



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura VIII

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti
Mbledhja nr. 147/2024
Prishtinë, më 29.10.2024, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Jeta Statovci, zëvendëskryetare e parë, Fidan Jilta, zëvendëskryetare e dytë, Mimoza Kusari-Lila, Driton Hyseni, Gramos Agusholli, Valentina Bunjaku - Rexhepi dhe Pal Lekaj anëtarë.

Munguan: Ferat Shala, kryetar dhe Abelard Tahiri, anëtar.

Të ftuar: Nazim Rahimi kryetar, Rrezarta Duraku, Lule Ahmeti dhe Arijan Qorolli, anëtarë të bordit të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare – ARKEP.

Pjesëmarrës tjerë: Astrit Ajvazi – ARKEP, Festim Bytyçi – GP AAK, Sami Gashi - GP LVV, Bjondina Çanta – Kuvend, Ermal Krasniqi – KDI, Salih Hoxha – GP LVV dhe mediat.

Stafi mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina dhe Veton Raci.

Mbledhjen e kryesoi Jeta Statovci, zëvendëskryetare e parë e Komisionit.

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur me datë 15.10.2024;**
- 3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare – ARKEP, për vitin 2023;**
- 4. Të ndryshme.**

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur me datë 15.10.2024

Procesverbali nga mbledhja e mbajtur me datë 15.10.2024, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare – ARKEP, për vitin 2023

Jeta Statovci, zëvendëskryetare e parë e Komisionit, kryesuese e mbledhjes, tha se në bazë të nenit 11 të Ligjit Nr. 04/L-109 për komunikimet elektronike, Autoriteti Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare – ARKEP raporton çdo vit në Kuvendin e Kosovës. Nga stafi e keni marrë një Memo më të cilin keni një analizë dhe disa pyetje lidhur me këtë raport vjetor.

Për ta prezantuar raportin ia kaloi fjalën z. Nazim Rahimi, kryetar i Bordit të ARKEP-it, dhe mandej hapim debat.

Nazim Rahimi kryetar i Bordit të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare – ARKEP, tha se Raporti i Punës së Aktivitetet e Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2023, paraqet një pasqyrë të ngjarjeve dhe zhvillimeve më të rëndësishme për vitin 2023, në tregun e komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare, si dhe të dhënat thelbësore për aktivitetet e rregulluara në këta sektor. Ndërsa në pjesën e fundit të raportit është paraqitur raporti financiar i Autoritetit, për vitin 2023, së bashku me raportin e Auditorit.

Krahas sukseseve të arritura në implementimin e kornizës rregullatore, ARKEP edhe gjatë vitit 2023, ka pasur sfida të shumta, ku nga më kryesoret janë: pavarësia financiare, numri shumë i vogël i resurseve profesionale në dispozicion dhe nevoja e domosdoshme për rritjen e mëtutjeshme, interesim i ulët i të rinjve për t'u punësuar si pasojë e nivelit të ulët të pagave të atakuara nga niveli ndjeshëm më i lartë i pagave në sektorët që i rregullon dhe mbikëqyr dhe vlerësimit të tyre si kuadro atraktive dhe deficitare për tregun.

Të arriturat kryesore të Autoriteti për gjatë vitit 2023 ndër të tjera janë: Dhënia në shfrytëzim e brezave frekuencore brezit 800 MHz dhe 3.6 GHz për dy ofruesit e shërbimeve të telefonisë mobile ‘Telekomi i Kosovës’ SH.A. dhe ‘IPKO Telecommunications’ LLC, duke krijuar kushtet për investime edhe në teknologjinë 5G. Këto resurse frekuencore janë caktuar në shfrytëzim sipas parimit të neutralitetit teknologjik dhe do jenë në dispozicion për shfrytëzim efektiv për periudhën njëzet (20) vjeçare. Përveç kësaj, ARKEP u ka krijuar lehtësira të shumta operatorëve duke filluar nga çmimi për spektër ndër më të ulët në Evropë dhe rajon, pastaj mundësia e pagesës në këste si dhe mundësi tjera, të cilat ndikojnë në shtrirjen më të shpejtë të rrjetave 5G. Në anën tjetër, me qëllim të arritjes së objektivave rregullatore, ARKEP ka vendosur obligime për operatorët sa i përket mbulueshmërisë si dhe sigurinë dhe integritetin e rrjetit, në veçanti sa i përket prodhuesve të dyshimtë.

ARKEP gjatë vitit 2023 si objektivë kryesore ka pasur fuqizimin e mëtutjeshëm të drejtave të konsumatorëve “Objektiv Strategjike - Konsumatori në Qendër”.

Për të mbikëqyrur përmbushjen e obligimeve të parapara me rregullat e reja të miratuara, ARKEP ka themeluar një departament të veçantë, i cili do të merret me mbikëqyrjen e tregut dhe mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve.

Në funksion të përmbushjes së objektivave për të rritur ndërgjegjësimin e konsumatorëve dhe fuqizimin e të drejtave të tyre sa i përket ofrimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike, ARKEP gjatë vitit 2023 në bashkëpunim me TAIEX ka organizuar punëtorinë mbi të drejtat e konsumatorëve bazuar në dispozitat e reja të parashikuara në Kodin e ri Evropian të Komunikimeve Elektronike (EECC). Gjatë punëtorisë, ekspertët nga vendet e Bashkimit Evropian (Sllovenia, Finlanda dhe Lituania) kanë prezantuar përvojat e vendeve të tyre për mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve.

Hartimi i dokumenteve të nevojshme për bartjen e numrave në rrjetet mobile dhe fikse të komunikimeve elektronike, dhe është zgjedhur operatori për implementimin e këtij projekti. Me implementimin e projektit për bartjen e numrave do të mundësohet avancimi i mëtutjeshëm i të drejtave të konsumatorëve, pasi që do t'u ofrohet mundësia për ndërrimin e operatorit pa pasur nevojë për ndryshimin e numrit. Përgatitja dhe Miratimi i Planit të ri Kombëtar të Radio Frekuencave për Republikën e Kosovës, i cili inkorporon rekomandimet dhe vendimet e reja Evropiane (ERC, CEPR ECC dhe ETSI) për të gjitha shërbimet e radio komunikimeve duke përfshirë përcaktimin e brezeve frekuencore ku mund të zbatohen teknologjitë e reja, duke përfshirë teknologjinë 5G.

Me datë 9 qershor 2023, në Mbledhjen e 55^{të} Plenare të Bordit të Rregullatorëve (BEREC) dhe Bordit Menaxhues, të mbajtur në Budvë të Malit të Zi, u nënshkrua Marrëveshja e Punës (Working Arrangement) në mes të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP) dhe Entit të Rregullatorëve Evropianë për Komunikime Elektronike (BEREC). Me nënshkrim të kësaj Marrëveshjeje, ARKEP vazhdon të jetë pjesëmarrës aktiv me të drejta të barabarta në punimet e BEREC-ut, përkatësisht në BoR, MB dhe CN, dhe të gjitha grupet punuese (EG) të BEREC. Nënshkrimi i Marrëveshjeve teknike me Autoritetet Rregullatore respektive me tri (3) shtetet fqinjë (Shqipërinë, Malin e Zi dhe Maqedoninë e Veriut) për harmonizimin e brezeve frekuencore brezit 800 MHz, 900 MHz, 1800 MHz, 2100 MHz, 2600 MHz dhe 3.6 GHz në zonat ndërkufitare.

Sfidë ende mbetet nënshkrimi i marrëveshjes për koordinimin e frekuencave ndërkufitare me Serbinë, obligim ky i cili ende nuk është përmbushur siç është paraparë edhe me marrëveshjen e Brukselit.

Gjatë vitit 2023 janë miratuar Rregulloret si në vijim: Rregullorja për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në ARKEP; Rregullorja për mbledhjen e të dhënave statistikore periodike nga ndërmarrësit e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike dhe postare.

Janë rritur kapacitetet për monitorimin e parametrave të kualitetit të shërbimeve të komunikimeve elektronike në përputhje me udhëzimet e BEREC-ut. Kjo ka mundësuar monitorimin e parametrave të kualitetit të shërbimeve në tërë territorin e Republikës së Kosovës për shërbimet mobile dhe fikse të komunikimeve elektronike.

Është miratuar Plani i shpërndarjes dhe shfrytëzimit të Brezitet të frekuencave 2500-2690 MHz për rrjetat e komunikimeve të lëvizshme & fikse (MFCN) sipas Vendimit Nr. 2184 dt. 18 Gusht 2023. Ka filluar analiza e tregjeve të terminimit të thirrjeve në rrjetet mobile dhe fikse të komunikimeve elektronike. Gjatë vitit 2023, janë pranuar katërqindetridhjetë e tetë (438) ankesa nga përdoruesit e shërbimeve të komunikimeve elektronike dhe për shërbimet postare, ndër të cilat dyqindetëdhjetë e katër (284) ankesa ishin për ofrimin e shërbimeve në pako të kombinuara (TV dhe internetit), ndërsa njëqindedyzet e nëntë (149) për shërbime të telefonisë mobile, tre (3) ankesa për shërbime postare. Deri në fund të vitit 2023 janë zgjidhur gjithsejtë

treqindegjashtëdhjetë e pesë (365) ankesa apo 83.33 % të ankesave të pranuar, prej tyre rreth 60% janë aprovuar, ndërsa 35%, e tyre janë refuzuar si të pabazuara.

Gjatë vitit 2023 ARKEP ka nxjerrë 95 vendime për resurse numerike, 10 autorizime të përgjithshme për ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike, janë revokuar 7 autorizime ndërmarrjeve për shkak se kanë dështuar 2 vite radhazi që të raportojnë ashtu si e parashikon neni 8.4 i Rregullores nr. 45 për pagesat për mbikëqyrje të tregut të komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare ashtu që janë hequr nga Regjistri i njoftimit. Ndërkaq 7 ndërmarrje kanë kërkuar të hiqen nga Regjistri i njoftimit për shkak të ndërprerjes së veprimtarisë së ndërmarrjeve përkatëse, 146 autorizime individuale për shfrytëzimin e resurseve frekuencore. janë lëshuar gjithsejt 11 licenca për Radioamatorë ndërkombëtarë ku përfshihen stacione radioamatore individuale dhe grupe, 3 autorizime të përgjithshme për ofrimin e shërbimeve postare, përkatësisht u janë revokuar autorizimet 5 ndërmarrjeve me kërkesë të tyre dhe pas përmbushjes së obligimeve ligjore janë hequr nga regjistri i ofruesve të shërbimeve postare.

Është përmbyllur me suksese projekti: Sistemi Nacional i Monitorimit të Spektrit Radio Frekuencor - SNMS. Janë realizuar 56 monitorime në terren për verifikimin e shfrytëzueshmërisë së brezeve frekuencore VHF, UHF për shërbimet Aeronautike dhe PMR, në brezin 900 MHz, 1800 dhe 2100 MHz, për teknologjitë 2G, 3G dhe 4G si dhe brezin SHF për linjat mikrovalore PtP. Janë publikuar katër (4) raporte të rregullta tremujore ‘Pasqyra e Tregut të Komunikimeve Elektronike.

Për sa i përket të hyrave Autoriteti për vitin 2023, ka planifikuar të hyra të rregullta në vlerën rreth 7.5 mil Euro, e që janë realizuar deri më datë 31 dhjetor 2023, ndërsa në mënyrë të shpalosur janë paraqitur në (*Pikën 7*), të këtij raporti.

Në aspektin e avancimit të transparencës dhe llogaridhënies gjatë vitit 2023, Autoriteti ka vazhduar të përmbushë obligimin e saj lidhur me publikimin e punëve dhe angazhimeve të kryera. Të gjitha informacionet dhe dokumentet relevante mbi aktivitetet e Autoritetit janë publikuar rregullisht në ueb faqen e Autoritetit.

Sa i përket planit të performancës për vitin 2023, ARKEP, ka pasur për qëllim t’i adresojë objektivat rregullatore të përcaktuara me Ligjin për Komunikimet Elektronike, Ligjin për Uljen e Kostos për Shtrirjen e Infrastrukturës së Komunikimeve Elektronike dhe Ligjin për Shërbimet Postare.

Armend Muja, pyeti në lidhje me borxhin e RTK-së ndaj ARKEP-it dhe që sa kohë daton ky borxh.

Nazim Rahimi – ARKEP, tha se RTK-ja ka shlyer të gjithë borxhin ndaj ARKEP-it dhe se ky ka qene një borxh i grumbulluar ndër vite.

Armend Muja, kërkoi një raport të plotë të borxheve ndër vite nga viti 2010 e tutje dhe sa prej tyre janë inkasuar. Po ashtu, ai pyeti në lidhje me drejtorin e MTS, z. Zoran Milojeviq, ku shofer i tij ka qenë terroristi Vladimir Radiojevic, i cili është përgjegjës për vrasjen e policit Afrim Bunjaku dhe plagosjen e policit Fatmir Elezi, dhe i njëjti ka marr pagë nga MTS, a mund të kemi një shpjegim se si ka pas mundësi të ndodh kjo. Po ashtu, ai pyeti se a po zbatohet dygjuhësia nga MTS. Ai po ashtu kërkoi një raport me shkrim të përdoruesve të rrjetit 4G.

Nazim Rahimi – ARKEP, tha sa i përket personit të apostrofuar dhe procedurës së ARKEP-it, përveç certifikatës së biznesit, pjesa tjetër është jashtë mandatit të ARKEP-it dhe tejkalon

kompetencat tona, në lidhje me dygjuhësinë ai tha se aplikohet në rastet e thirrjeve emergjente. Për pjesën tjetër nuk jam i sigurt se sa është duke u respektuar.

Armend Muja, pyeti në lidhje me rënien e përqindjes së qarkullimit të Postës së Kosovës diku nga 68% në rreth 30%, çka ka ndikuar në këtë rënie të ofrimit të shërbimeve në tregun e dërgesave postare nga Posta e Kosovës.

Nazim Rahimi – ARKEP, tha se tek shërbimet postare, kemi konkurrencë kryesisht nga sektori privat, të cilët janë më agresiv në treg dhe kane rritje të madhe të ofrimit të shërbimeve. Posta e Kosovës nuk e ofron shërbimin e marrjes dhe dërgimit të dërgesës, po ashtu, ka ndikuar edhe fiskalizimi sepse Posta e Kosovës nuk ofron shërbim pa kupton fiskal kurse operatorët private edhe mund të ofrojnë shërbime të tilla pa ofruar kuponin fiskal.

Kryesuesja, pyeti në lidhje me ueb faqen e ARKEP-it, në rubrikën shërbime postare nuk keni asnjë përditësim nga viti 2019, pse po ndodh kjo, ajo pyeti në lidhje me mbikëqyrjen e dërgesave në lidhje me sigurinë dhe transparencën nga ofruesit e shërbimeve postare.

Nazim Rahimi – ARKEP, tha se ligjërisht ARKEP obligohet të publikojë një herë në vit një raport të punës, në atë raport pasqyrohen edhe shërbimet postare. Të dhënat për shërbimet postare paraqiten në raport dhe nëse do të bënim një raport të veçantë na duhen burime njerëzore shtese. Nisur nga baza ligjore operatorët që ofertojnë shërbime postare janë të obliguar të paraqesin raporte të rregullta, në raste të caktuara në i inspektojmë dhe mbikëqyrim procesin e punës së ofruesve të shërbimeve postare dhe nëse shohim se ka ndonjë mos raportim atëherë marrim masa.

Driton Hyseni, pyeti në lidhje me alokimin e brezit frekuencore 800 MHz dhe 3.6 GHz, në raportin e vitit 2023, vërejmë se ankesat e konsumatorëve në vitin 2023 në raport me ankesat e konsumatorëve në vitin 2022 janë rritur në masë të madhe për sa i takon telefonisë mobile, ku qëndron problemi.

Nazim Rahimi – ARKEP, tha se ne i kemi dhënë brezet frekuencore në muajin shkurt 2023 dhe operatorët kane filluar më vonë me dhënien e shërbimeve dhe atëherë varet ndryshimi i shërbimeve, kjo do të jetë e dukshme në vitin 2024.

Lule Ahmedi - ARKEP, tha se numri i ankesave pasqyron cilësinë e shërbimeve, në vitin 2023 ende nuk ka pas cilësi të kënaqshme të shërbimeve dhe këto shërbime vetëm në vitin 2024 do të vërehet se cilësia e shërbimeve ka ndryshuar.

Driton Hyseni, në lidhje me operatorët privatë postarë, sa po mund t'i monitorimi dhe si është qasja e ATK-së dhe Doganës së Kosovës ndaj tyre në lidhje me fiskalizimin e tyre. Ai pyeti sa ka mundur ARKEP ta mbështes ofruesin të shërbimeve universal postare.

Nazim Rahimi – ARKEP, tha për vitin 2023 kemi konstatuar humbje mbi 1 milion euro, kërkesa e tyre ka qenë diku rreth 1.5 milion euro, nga raporti i zyrtarit që ka kryer auditimin e brendshëm, erdhëm në përfundim se vlera që Posta e Kosovës duhet ta kenë është ajo vlera e cila është konstatuar si humbje nga Posta e Kosovës. Në lidhje me operatorët privatë të postave të shpejta, kohet e fundit kemi rritje të shërbimeve të shitjes online dhe operatorët privatë janë me

fleksibil në ofrimin e shërbimeve të tilla. Në lidhje me mbikëqyrjen dhe koordinim me institucionet tjera, ne kemi zhvilluar takim me Drejtorin e ATK-së, në lidhje me një raste të identifikuar i cili nuk lëshonte kupton fiskal, nuk është treguar interesim nga ana e tyre që së bashku me ne ta trajtojmë si rast, po ashtu kemi komunikim të vazhdueshëm edhe me Doganën në lidhje me futjen e produkteve në rrugë ilegale nga Maqedonia e Veriut në vendin tonë.

Driton Hyseni, pyeti në lidhje zhvillimet e reja me aprovimin e operimit të Starling-ut, sa prisni që do të ndikojë në ofrimin e shërbimeve të internetit dhe a do të ndikojë në uljen e kostos së shërbimeve të tilla futja në treg e këtij operatori. Duhet të kemi parasysh që ky operator duhet të përfill shtetësinë e Kosovës dhe hartën tonë që të mund të ofrojë shërbime në vendin tonë.

Rrezarta Duraku – ARKEP, tha se ende nuk kemi përditësim në hartën e tyre sepse ende nuk ka filluar ofrimi i shërbimeve në vendin tonë nga Straling, në momentin që do të fillohet me ofrim të shërbimeve, sigurisht që do të bëhet edhe përditësimi në hartat e tyre. Ajo tha se nuk do të konsiderohet si konkurrent i ofruesve aktual të shërbimeve të internetit, kjo për shkak të cilësive të veçanta që i ka Starling. Benifiti kryesor që fiton Kosova me futjen e Starling në tregun tonë, ka të bëjë me aspektin e rritjes së sigurisë nacionale për shkak që në kohë krizash siç janë luftuat dhe fatkeqësitë natyrore, për shkak të infrastrukturës që ka Straling, është shumë i nevojshëm ofrimi i shërbimeve të Starling.

Driton Hyseni, pyeti në lidhje me kriteret e mbrojtjes së konsumatorëve, sidomos për kontratat e pakove televizive dhe shërbimeve të përbashkëta, po ashtu në lidhje me problemet që po hasin mërgimtarët në skadimin e kontratës për një periudhë shumë të shkurtër kohore, kontrata invalidohet shumë shpejtë dhe pastaj duhet të fillohet nga pika zero sepse bëhet shkëputja e kontratës. Ai pyeti, sa është periudha kohore për një kontrate e cila nuk po merr shërbim që ndërpritet ose konsiderohet totalisht e ndërprerë.

Nazim Rahimi – ARKEP, tha se gjatë vitit 2023 është punuar në rregulloren për kontrata, mbrojtje të konsumatorëve, transparence të informacioneve dhe masave tjera për përdoruesit fundor të komunikimeve elektronike, ne kemi bashkëpunuar edhe me KPM-në dhe jemi munduar të pasqyrojmë nevojat e mbrojtjes së konsumatorit fundor dhe pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, kemi siguri me të lartë të mbrojtjes së konsumatorit fundor.

Rrezarta Duraku – ARKEP, tha në lidhje me përfundimin e kontratave, zakonisht ka kontrata 1 vjeçare dhe 2 vjeçare, periudha detyruese është 9 muaj, ideja e kontratave me të gjata është për shkak të çmimit më të mirë. Në lidhje me konsumatorin dhe dëshiron të largohet nga kontrata pa asnjë arsye, periudha detyruese është 9 muaj.

Pal Lekaj, tha se ne kemi një marrëveshje sa i përket roaming-ut me shtetet në regjion dhe Bashkimin Evropian, në raport e keni cekur që e keni monitoruar këtë marrëveshje, sa po implementohet dhe a ka vështirësi në implementim kjo marrëveshje.

Nazim Rahimi – ARKEP, tha se kemi marrëveshje të roaming-ut me 5 vende të Ballkanit Perëndimor, nuk behet monitorim në baza të rregullta mujore por që monitorimi behet dhe është duke u zbatuar kjo marrëveshje.

Pal Lekaj, tha ju përgëzoj për funksion të frekuencave 5G në Prishtinë, por nëse del jashtë Prishtinës, nuk ka fare funksionim të internetit kohë pas kohe, ku është problemi, a jeni fokusuar vetëm në kryeqytet, shembull në Gjakovë, në qendër të qytetit ka pengesa në ofrimin e internetit, ku qëndron problemi.

Nazim Rahimi – ARKEP, tha se operatorët kanë përmirësuar shërbimin dhe mbulimin e të gjitha akseve rrugore në të gjitha regjionet, mirëpo në pjese të caktuara për shkak të konfiguracionit gjeografike mund të mos ketë depërtim të mjaftueshëm të shtrirjes së internetit.

Rrezarta Duraku – ARKEP, tha se vendimet që merr ARKEP, duan kohë derisa të shihen rezultatet në terren, pas dhënies së brezave frekuencore, operatorët duhet të investojnë dhe koha që i duhet të implementojë projektet që të shohim kualitetin e shërbimeve, është normale që merr pak kohë. Operatorëve ju kemi krijuar lehtësira të mëdha në aspektin e investimeve, besojmë që do të vërejnë mbulueshmërinë dhe cilësinë e ofrimit të shërbimeve.

Pal Lekaj, pyeti, a ka ende antena ilegale të vendosura në Kosovë.

Astrit Ajvazi – ARKEP, tha se për herë të parë, nga viti i kaluar ARKEP ka filluar monitorimin edhe në veri të vendit, përveç monitorit është bërë edhe inspektimi i pajisjeve të MTS të cilat janë të autorizuar nga ARKEP dhe pajisjet të cilat janë gjetur dhe nuk kanë qenë të autorizuar nga ARKEP, janë konfiskuar. Nuk ka pajisje e as antena të cilat nuk janë të autorizuar e të cilat operojnë në Kosovë. Brezat frekuencore që të cilat janë të vendosura në manastire dhe kisha serbe janë të vendosura sipas marrëveshjes së Brukselit dhe janë breza frekuencore të kufizuara dhe nuk lejohet ndryshimi i lokacionit të tyre.

Nazim Rahimi – ARKEP, tha se përveç monitorimit të brendshëm, ne kemi monitorim të ndikimit të frekuencave nga antenat e vendosura në territorin e shtetit serb, këtë çështje e kemi adresuar dhe nuk kjo paraqet një problem për ne.

Kryesuesja, pyeti se a dihet saktë numri i abonentëve të MTS në Kosovë.

Nazim Rahimi – ARKEP, tha se nuk e di numrin e saktë por i kemi të pasqyruara në raportet t e veçanta 3 mujore. MTS fokusin kryesisht e ka në ofrimin e shërbimeve të internetit dhe TV kabllor.

Kryesuesja, pyeti sa ka mbulueshmeri të operatorit publik në raport me ofrimin e shërbimeve të internetit dhe TV në atë pjesë.

Arijan Qorolli - ARKEP, tha se dy operatorët siç janë Ipko dhe Vala janë mjaft prezent në pjesën veriore, ku i mbulojnë qytetet kryesore dhe natyrisht ka qasje të vazhdueshme në atë pjesë të vendit. Operatori Ipko ka diku 10 stacione bazë të vendosura dhe operatori Vala ka mbi 13 stacione që janë aktive dhe mbulojnë komplet pjesën veriore. Kemi hasur edhe në operatorë që kanë ofruar shërbime në mënyre ilegale dhe tani kemi edhe 4 operatorë të cilët janë autorizuar që të ofrojnë shërbime konform rregullativës së ARKEP-it.

Kryesuesja, pyeti, në raport me njoftimet e fundit nga Posta e Serbisë, a keni informata që mund të ndani me ne.

Nazim Rahimi – ARKEP, tha se kemi njoftuar autoritetet kompetente se Posta e Serbisë nuk ka autorizim nga ARKEP-i për të vepruar dhe veprimet janë ndërmarr në mbylljen e 9 pikave në veri dhe Posta e Kosovës ka hapur pikat e tyre për ofrim të shërbimeve në atë pjesë të vendit.

Armend Muja, pyeti se a mund të dërgohen SMS nga operatori Vala ose Ipko në operatorin MTS dhe a realizon MTS të ardhura nga roamingu dhe a i deklaroi ato.

Arijan Qorolli – ARKEP, tha se nuk e kemi monitoruar këtë gjë, por ish dashur që të funksiononte dërgimi i SMS-ve në MTS, mirëpo, nuk kemi të dhëna për këtë dhe nuk kemi pasur raste të raportuara nga konsumatorët që kjo gjë nuk po funksionon.

Nazim Rahimi – ARKEP, tha se sipas legjislacionit në fuqi, brenda territorit të Kosovës, MTS nuk ka të drejtë të realizoj taksa të roming-ut.

Rrezarta Duraku – ARKEP, tha, faktikisht po, realizon të hyra nga roming operatorit MTS në Kosovë, por teknikisht është e pamundur të behet ndarja e të ardhurave nga të ardhurat që realizon kompania ame. Ky është problem teknik si pasoje e marrëveshjes se Brukselit sepse kodi shtetëror që përdor MTS është kodi shtetëror i Serbisë. Nuk ka mundësi të behet deklarimi i këtyre të ardhurave nga romingu.

Armend Muja, pyeti a keni dëgjuar për operatorin Vgn Do.

Arijan Qorolli - ARKEP, tha se operatori VgnNet ka qenë operator privat në veri të vendit dhe e ka ndërruar pronësinë, tani MTS është 100% pronar i Vgn Net. Mirëpo, kalimin e pronësinë nuk e ka bërë sipas legjislacionit në fuqi dhe tash Autoriteti i Konkurrencës e ka gjobitur dhe lënda nëse nuk gaboj është në procedure gjyqësore.

Armend Muja, kërkoi informacione me shkrim në lidhje me operatorin Vgn. Po ashtu, ai pyeti a ka ndonjë raport të saktë të abonentëve të shërbimeve fikse të MTS. Këto shërbimet fikse a i ofron MTS apo kompanitë bije të saj që i ofron këto shërbime.

Arijan Qorolli - ARKEP, tha se MTS si çdo operator tjetër, plotëson raportet statistikore dhe raportin vjetor financiar të audituar e dorëzon. Kompania Deloit, plotëson pyetësorët dhe i dorëzon tek ne, në emër të MTS. Ne lidhje me mirëmbajtjen është një kompani bije e MTS e cila e ofron këtë shërbim.

Armend Muja, kërkoi të dërgohet raporti me shkrim për ofruesit e shërbimeve fikse nga MTS dhe kompanitë bije të saj. Ai tha se ne ueb faqe, ju po ofroni ndarje të tregjeve për komunikimet elektronike, por jo edhe për komunikimet postare. Ai kërkoi një raport të veçantë për komunikimet postare për vitin 2023 për operatorët privatë. Po ashtu, Muja pyeti, sa për qind e konsumatorëve janë të mbuluar me 5G deri me tani?

Arijan Qorolli - ARKEP, tha se jemi në punim e sipër të platformës Digital ARKEP dhe besoj qe nga 3 mujori i katërt 2024 do të marrim të dhënat e parapaguesve 5G.

Armend Muja, tha a kemi ndonjë analize se çfarë duhet të bëjë shteti që të shtrihet rrjeti 5G në të gjithë vendin sa më parë dhe a keni ndonjë krahasim me shtetet e rajonit në lidhje me shtrirjen e rrjetit 5G.

Nazim Rahimi – ARKEP, tha për nga dhënia e frekuencave për shtrirjen e rrjetit 5G jemi të tretët në rajon, është Maqedonia e Veriut e para, pastaj Mali i Zi, Kosova dhe pastaj vijne Shqipëria, Serbia dhe Bosnje Hercegovina. Neve na duhet lirimi i brezit 700.

Armend Muja, pyeti në lidhje me inteligjencën artificiale, a keni pas ndonjë diskutim në lidhje me rreziqet nga inteligjenca artificiale.

Lule Ahmedi – ARKEP, tha se BE-ja e ka aktin për inteligjencën artificiale dhe janë përpiluar kriteret se cilat shërbime digjitale duhet të kalojnë nëpër filtra me qëllim të mbrojtjes së të dhënave personale, por nuk ka ndonjë specifikim se cili organ shtetëror do të marrë këto përgjegjësi.

Armend Muja, kërkoj nga ARKEP që të analizohet rreth rreziqeve të inteligjencës artificiale dhe përfshirjes së këtyre rreziqeve në strategjinë kombëtare në mënyrë që të kemi masa preventive me kohë. Pyeti se a keni dëgjuar në lidhje me një vendim të Gjykatës Evropiane për shkak të ankesës që ka bërë Spanja lidhur me pjesëmarrjen e ARKEP-it në një këshill, ishte vitin e kaluar dhe shqetësues si aktgjykim sepse mund të përdoret si rast precedent.

Lule Ahmedi – ARKEP, tha se ne media ka qarkulluar si lajm që Kosova është përjashtuar prej trupës së rregullatorëve të BE-së, në fakt çështja ka qenë tejkallim i kompetencave të Komisionit Evropian për me pranuar jo vetëm Kosovën, por edhe shtete tjera të Ballkanit Perëndimor. Me ankesën e Spanjës është kthyer në pikën zero, jo vetëm anëtarësimi i Kosovës, por edhe vendeve tjera fqinje.

Armend Muja, i përgëzoi ARKEP-in për punën e tyre dhe konstatoj që janë prej rregullatorëve më të mirë në Kosovë.

Nazim Rahimi – ARKEP, tha se kërkoj mbështetje në lidhje me shtimin e stafit brenda ARKEP-it, sepse si institucion kemi probleme me rekrutim të stafit për shkak të koeficientit të ulët, sidomos tek rekrutimi i ekspertëve.

Lule Ahmedi - ARKEP, kërkoi mbështetje për stafin profesional, në mënyrë që të mund të ruhen burimet njerëzore të ARKEP-it.

Nazim Rahimi – ARKEP, tha se në këtë vit ARKEP feston 20- vjetorin e themelimit, andaj ftoj deputetet që të marrin pjesë në këtë përvjetor.

Pas debatit, kryesuesja konstatoi, se duhet të presim raportet me rekomandime të Komisionit për buxhet dhe Komisionet për financa publike, mandej e procedojmë në seance rezolutën siç parashihet me ligj dhe rregullore.

5. Të ndryshme

Çështjet vijuese

Kryesuesja, tha se për sot një javë, më 5 nëntor, nga ora 10:30 mblidhet Komisioni/Paneli për përzgjedhjen e kryesuesit të KSh në ARRU, për të vazhduar me procesin intervistues nga ora 11:00 dhe mandej mbledhjen për miratimin e raportit të Panelit.

Mbledhja përfundoi në orën 13:30.

E përgatiti: Stafi mbështetës i Komisionit.

Jeta Statovci,

Zëvendëskryetare e parë e Komisionit